



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 2036/2 prot.

Gramsh, më 04.07/2023

VENDIM
Nr. 42, datë 30.06.2023

Mbi Deklarimin e Mbarimit të Mandatit të Këshilltarit z.Servet Dedja

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës datë 30.06.2023 pasi mori në shqyrtim, kërkesën me nr.Regj.2044 datë 08.06.2023 mbi dorëheqjen e parevokueshme nga pozicioni i Këshilltarit Bashkiak të z.Servet Dedja, në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, nenit 49 pika 4 shkronja (b), neni 54 shkronja (j) dhe nenit 55 pika 3, si dhe referuar Raportit të Komisionit të Mandateve Çështjeve Juridike dhe Administrative me nr.2069/1 Prot. Datë 14.06.2023, Këshilli Bashkiak :

VENDOSI:

- 1- Miratimin e Raportit të Komisionit të Mandateve Çështjeve Juridike dhe Administrative për deklarimin e mbarimit të mandatit të Këshilltarit z.Servet Dedja.
- 2- Njoftimin e vakancës Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve Tiranë, për vijimin e procedurave për plotësim vakance.
- 3- Ngarkohet Sekretari i Këshillit Bashkiak, Komisioni i Mandateve Çështjeve Juridike dhe Administrative për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
- 4- Ky vendim hynë në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Xhulia GJINI



Kryetari i Këshillit Bashkiak
Evis ZANI

Konceptoi: Xh.Gjini
Pranoi: E.Zani
Miratoi: E.Zani
Dosja nr: _____
Afati i ruajtjes: RHK